



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:099942

Datë: 12.11.2024

Numri i dokumentit: 06437655

PPP.nr.09/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë përmbarimore e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha, duke vendosur në çështjen përmbarimore të kreditorit D. Sh. nga Komuna Kaçanikut, të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat F. T. nga Kaçaniku, kundër debitorit K. K. D. K. A. , e duke vendosur lidhur me prapsimin e debitorit, më datë 12.11.2024 morri dhe shpalli këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET, në tërësi si i pabazuar Prapësimi i debitorit, K. K. D. K. A. , i ushtruar më date 22.03.2024 kundër Urdhrit Përmbarues me P.nr.401/24 i dt. 19.03.2024.

II. DETYROHET, debitori që ta bëjë ekzekutimin e propozimit Urdhrit Përmbarimor P.nr.401/24 i dt. 19.03.2024, lëshuar nga përmbaruesi privat Sh. L. nga Kaçaniku si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë 3,516.34€, me kamat 8% nga data 29.06.2021, si dhe shpenzimet e përmbarimit të cilat i cakton përmbaruesi privat, kjo pagesë do të bëhet në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Kreditori D. Sh. nga Kaçanikut përmes të autorizuarit Avokat F. T. nga Kaçaniku, me datën 19.03.2024, ka ushtruar propozim për përmbarim te përmbaruesi privat Sh. L. nga Kaçaniku, kundër debitorit K. K. D. K. A. , ka kërkuar që të lëshohet Urdhër dhe të lejohet përmbarimi sipas propozimit dhe të deyrohet debitori që në afat prej 7 ditësh, kreditorit të ja

paguaj shumën e të hollave në vlerë prej 3,516.34€ me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga data 29.06.2021, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore në lartësi prej 156.00€, për përpilimin e propozimit si dhe për taksës dhe shpenzimet tjera sipas specifikacionit të përmbaruesit, me bartjen e mjeteve financiare nga kontot bankare të debitorit të hapura në Bankat e Kosovës dhe të barten në konton e veçantë bankare për kreditorët të përmbaruesit privat Sh. L., në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrimit me kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbaruesi Privat më datë 19.03.2024 ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit K. K. D. K. A. , ndërsa me nga një kopje të propozimit është njoftuar debitori i cili në afatin e paraparë ligjorë ka paraqitur Prapësim.

Debitori me prapësim i ka propozuar gjykatës, që të miratohet prapësimi, të shfuqizohet urdhri i përmbaruesit privat nr. P.nr.401/2024, i datës 19.03.2024, dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra, duke theksuar se e kundërshton si të pa pabazuar urdhrin për lejimin e përmbarimit të propozuar nga kreditorit, për shkak të vërtetimit të gabuar, jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike.

Ndaj këtij prapësimi kreditori përmes të autorizuarit të tij Avokat F. T. nga Kaçaniku ka paraqitur përgjigjen në prapësim duke i propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar, sepse i njëjti nuk është i mbështetur në prova.

Gjykata e refuzoi prapësimin e debitorit, si të pa bazuar, për arsye se debitori prapësimin, nuk e ka mbështetur në provat, asnjë provë nuk ja ka bashkangjitur prapësimin siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, si dhe nuk ka paraqitur asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 nga pika 1.1 deri tek pika 1.12 të LPP-së. Prandaj gjykata duke i pasur për bazë të gjitha këto fakte të konstatuara vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Përmbaruesi privat, dorëzimin e propozimit për përmbarim, urdhrimit dhe provave tjera, ja ka dorëzuar debitorit konform nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit të procedurës përmbaremore

Gjykata pas pranimit të propozimit, analizimit të provave të bashkangjitura, ka gjetur se propozimi për përmbarim, është i bazuar, në dokumentin përmbarimor siç është paraparë, me neni 22 par 1 pika 1,1 të Ligjit të procedurës përmbaremore, pra propozimin e ka bazuar në vendim përmbarues të Gjykatës.

Gjykata i analizoi pretendimet e kreditorit të paraqitura me propozim për përmbarim dhe këtyre pretendimeve u a fali besimin, sepse kreditori propozimin për përmbarim, e ka bazuar në dokumentin përmbarimor, siç është paraparë me nenin 22 par 1 pika 1,1 të Ligjit të procedurës përmbarimore.

Gjykata i analizoi edhe pretendimet e të autorizuarit të debitorit, i cili i ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor. Gjykata ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar, nuk është i mbështetur në prova siç është paraparë në dispozitën ligjore të nenit 69. par.4 të LPP-së. Po gjykata ka gjetur se prapësimi nuk i plotëson kushtet e parapara me neni 71 nga pika 1-12, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata i detyroi debitorin të ja paguaj shumën si në propozimin për përmbarim, shpenzimet e procedurës përmbarimore të cilat do të llogariten nga ana e përmbaruesit privat, sipas Udhëzimit Administrativ për Tarifat dhe Shpërblimet dhe Shpenzimeve për Përmbaruesit Privat, si dhe për përpilimin e propozimit për përmbarim sipas TOAK-së, si dhe konform nenit 13, par.4 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

PPP.nr.09/24, datë 12.11.2024

Gjyqtari:

Burhan BERISHA

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, ankesa i parashtrohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.